



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE**  
**KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE**

---

Nr. 9 Prot

Tiranë, më 03.04 2012

**VENDIM Nr. 4 dt. 30.03.2012**

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9882, dt 28.02.2008, "Për Trashëgiminë Kulturore", Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 30.03.2012, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara në Institutin e Monumenteve të Kulturës, sipas pikave të rendit të ditës:

**VENDOSI**

**Lidhur me:**

**Diskutimi i kërkesave të qytetarëve**

1. **Miratohet:** Projekt restaurimi, rikonstruksioni dhe përshtatje i rrënojave pas xhamisë së beqarëve sot në pronësi të Fatbardha (Polikseni) Kodhelit, lagja "Mangalem", Berat.
2. **Nuk miratohet:** Projekt kons. dhe rest. banesa e Llavdës, sot "Muzeu Etnografik", lagja "13 Shtatori", Berat. **(Të rishikohet pozicioni i vendosjes së tualeteve).**
3. **Miratohet:** Projekt restaurimi i ish banesës së Nikollaq Haxhos sot në pronësi të Luto Myftarit, lagja Goricë, Berat.
4. **Miratohet:** Projekt përshtatje i banesës së Roland Bostanit, lagja Kala, Berat.
5. **Nuk u diskutua:** Projekt ndërtimi i kompleksit të banimit dhe shërbimit 2,3, kat, rruga Skënderbeg, Shkodër, me porositës Shefik Dibra.
6. **Miratohet:** Projekt rikonstruksioni i banesës 2 katëshe me pronar Albert Brahimllari, Korçë.

7. **Miratohet:** Projekt rikonstruksion banese e shtesë kati, investitor Tefta Bala, lagja nr.1, bulevard "Republika, Korçë.
8. **Miratohet:** Ndërtim qendër biznesi + banimi, Korcë, porisitës Jorgjia Haloci.
9. **Miratohet:** Projekt i rikonstruksionit të banesës individuale 1-2 kate podrum, në rrugën Perlat Rexhepi, e ndodhur në zonë të mbrojtur, me pronar Z. Ilir Sosoli, Korcë.
10. **Miratohet:** Projekt rikonstruksioni banese 1 dhe 2 kate plus bodrum, me pronar Eleni Llazari, Korçë.
11. **Miratohet me vetëm një votë kundër::** Projekt rikonstruksion banese 2 kate me pronar Pavlina Pali, Korçë.
12. **Miratohet:** Projekt rikonstruksioni dhe formulim arkitektonik i objektit 2 kate, lagjia Kala, Elbasan, me pronar Alberto Ali Derstila. (Projekti të zbatohet nën mbikëqyrjen e ASHA-s).
13. **Nuk miratohet:** Projekti i riformulimit të ndërtesës tre katëshe me bodrum rruga "Kardinal Mikel Koliqi", Shkodër me pronar Mark Beka. **(Të risillen në KKR variantet me dy dhe tre kate të formulimit të banesës, të plotësuara me dokumentacionin e fotomontazhit të objekteve rrethuese).**

- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
- Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R**  
**ALDO BUMÇI**

**SEKRETAR I KKR**  
**AKADEMIK. APOLLON BAÇE**